



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court**

Prishtinë, 15 tetor 2010
Nr. Ref.: RK 50/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 20/10

Muhamet Bucaliu

kundër

Vendimit të Prokurorit të Shtetit KMLC.nr. 09/10 të 24 shkurtit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Muhamet Bucaliu, me vendbanim në Ferizaj.

Vendimi i sfiduar

2. Parashtruesi e sfidon vendimin e Prokurorit të Shtetit KMLC nr. 09/10 të 24 shkurtit 2010.

Çështja e lëndës

3. Parashtruesi ankohet se nuk e ka marrë vendimin për përmbarrim të Gjykatës Komunale të Ferizajt të 11 janarit 2008 dhe se e njëjta gjykatë nuk ka vendosur në lidhje me këtë rast brenda afatit të padisë, me rastin e përcaktimit të vlerës së pronës.
4. Ai pohon që neni 24 (1) [Barazia para Ligjit], neni 31 (1) [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [e Drejta për Mjete Juridike], dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës janë shkelur.
5. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë për kërkesën e tij për masa të përkohshme kundër procedurës përmbarrimore në lidhje me pronën e tij për ta evituar çdo rrezik për dëm të pariparueshëm.

Baza juridike

6. Neni 113(7) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Kushtetuta), neni 22(7) dhe (8) dhe neni 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejshëm Ligji), dhe nenet 51, 53 dhe 54 (b) të Rregullores së punës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

7. Më 4 mars 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë në Gjykatë me të cilën e sfidonte Vendimin e Prokurorit të Shtetit KMLC nr. 09/10 të 24 shkurtit 2010, dhe dorëzoi në Gjykatë një kërkesë për masa të përkohshme.
8. Më 13 korrik 2010, kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami, e shqyrtuan raportin e gjyqtarës raportuese Snezhana Botusharova dhe rekomandoi Gjykatës së plotë në lidhje me kërkesën e Parashtruesit për masë përkohshme dhe papranueshmërinë e Kërkesës.

Faktet

9. Nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi shihet që më 14 qershor 2005 ai kishte lidhur marrëveshje mbi hipotekën (Marrëveshja nr. 11715/H) me Raifeissen Bank, me ç'rast kishte lënë patundshmërinë e tij (Ngastrën Kadastrale Nr. 1071 në Ferizaj) peng për kreditin dhënë debitorit "Nera Impex" në Ferizaj.
10. Më 20 qershor 2005, zyra kadastrale komunale në Ferizaj vendosi ta regjistronte marrëveshjen mbi hipotekën (Vendimi mbi Regjistrimin e Hipotekës me nr. të protokollit: 25-72217092-00584).
11. Më 10 janar 2008, Raifeissen Bank ia dorëzoi një kërkesë Gjykatës Komunale të Ferizajt për përmbarrimin e shitjes së pronës së parashtruesit pasi debitori kishte dështuar ta respektonte marrëveshjen mbi hipotekën.
12. Me Vendimin E.Nr. 04/2008 të 11 janarit 2008, Gjykata Komunale e miratoi kërkesën e Raifeissen Bankës për përmbarrim.
13. Më 20 tetor 2009, Gjykata Komunale e Ferizajt (Vendimi E.Nr. 04/2008, i 20 tetorit 2009), pa mbajtur seancë, vendosi për vlerën e patundshmërisë, dhe e caktoi vlerën e përgjithshme në shumë prej 1,096,500 eurove në përputhje me vlerën në treg. Vlerësimi u bë nga një ekspert financiar në mars të vitit 2008. Gjykata gjithashtu vendosi për konkluzionin mbi shitjen publike të patundshmërisë dhe pronës së lënë peng, që ishte caktuar për 15 shkurt 2010.

14. Parashtruesi u ankua në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës kundër vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt duke thënë që gjykata e kishte vlerësuar gjendjen faktike në mënyrë të gabuar.
15. Më 11 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut e Prishtinës (Vendimi Ac.Nr. 1292/2009, i 11 nëntorit 2009) e hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të pabazuar dhe e mbështeti vendimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt për ta lejuar përmbarimin. Gjykata e Qarkut konkludoi se vlerësimi i gjendjes faktike ishte i saktë dhe ishte bërë në përputhje me ligjin e zbatueshëm.
16. Më 8 shkurt 2010, parashtruesi ngriti padi në Gjykatën Komunale të Ferizajt duke kërkuar anulimin e Vendimit E.Nr. 04/08, të 11 janarit 2008.
17. Të njëjtën ditë, parashtruesi ngriti padi për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Prokurorit të Shtetit kundër vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt dhe vendimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Prokurori i Shtetit gjeti që nuk kishte pasur bazë ligjore për padi dhe konkludoi që parashtruesi, si garantues i debitorit Nera Impex, dhe vetë debitori ishin në seancën e Gjykatës Komunale të Ferizajt më 22 shtator 2009 dhe se asnjëri prej tyre nuk kishte paraqitur kundërshtim kundër përmbarimit, përveç një padie kundër përcaktimit të vlerës së pronës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se nuk e ka marrë vendimin për përmbarim të Gjykatës Komunale të Ferizajt të 11 janarit 2008 dhe se Gjykata Komunale e ka shkelur nenin 47(1) dhe (2) të Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore.
19. Parashtruesi pretendon më tej se Gjykata Komunale në Vendimin E.Nr. 04/2008 të 20 tetorit 2009 nuk kishte vendosur brenda afatit të padisë, pasi e kishte përcaktuar për ekzekutimin e tërë patundshmërisë, në vend të pronës së cekur në listën poseduese nr. 1071. Sipas mendimit të tij, Gjykata Komunale shkeli nenet 49 dhe 22 të Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore dhe nenin 22 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.
20. Parashtruesi pohon që neni 24(1) [Barazia para Ligjit], neni 31(1) [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [e Drejta për Mjete Juridike], dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës janë shkelur.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

21. Duke marrë parasysh faktet e ofruara nga parashtruesi, Gjykata gjen që parashtruesi ka dështuar të provojë që ekziston rasti *prima facie* në mënyrë që Gjykata të vendosë në lidhje me kërkesën e tij për masa të përkohshme, siç kërkohet me nenin 27 të Ligjit.
22. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa për masa të përkohshme është e pambështetur, parashtruesi nuk e ka dorëzuar asnjë argument bindës që do të mund ta mbështeste dëmin e pariparueshëm, sikur kërkesa e tij për masa të përkohshme të mos lejohej.

Vlerësimi për pranueshmërinë e kërkesës

23. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Megjithatë, sa i përket kriterit që parashtuesi duhet të tregojë se i ka shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, Gjykata vëren se parashtuesi ka mundur të paraqiste ankesë në Gjykatën Komunale të Ferizajt dhe në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë që ai nuk e kishte marrë Vendimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt E.nr. 04/08 të 11 janarit 2008 dhe se e njëjta gjykatë, në vendimin e vet përmbaues, kishte dalë jashtë afateve të padisë. Në vend të kësaj, parashtuesi ka dorëzuar vetëm një padi kundër përcaktimit të vlerës së pronës.
25. Nga kjo rezulton që parashtuesi nuk ka provuar se i ka shterur të gjitha mjetet ligjore të ofruara me ligjin e zbatueshëm.
26. Prandaj, Gjykata konkludon që Kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

27. Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 dhe 47 të Ligjit, dhe nenin 54 (b) të Rregullores së punës, në seancën e datës 15 tetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masa të përkohshme.
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- III. Ky Vendim do t'u dërgohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Snezhana Botusharova, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani, d.v.